

20030721561

L I G J I
PËR NGARKIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË ME HUA NË BANKËN
JAPONEZE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR SIPAS MARRËVESHJES PËR
HUA PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT PËR PËRMIRËSIMIN E SHFRYTËZIMIT TË
UJIT NË BASENIN E LUMIT ZLETOVICA

Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet me hua në Bankën Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar në shumë prej 9.689.000.000 jenësh japonezë, destinuar për realizimin e Projektit për përmirësimin e shfrytëzimit të ujit në basenin e lumit Zletovica.

Me këtë hua do të financohet 75% e ndërtimit të fazës së parë të hidrosistemit shumëdestinues “Zletovica”.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huasë nga neni 1 i këtij ligji, janë të konfirmuara me Marrëveshje për hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Neni 3

Afati për pagesën e kthimit të huasë nga neni 1 i këtij ligji është 25 vjet, me 7 vjet grejs periudhë dhe shkallë kamatore prej 1,5% në vit.

Huaja do të paguhet në 37 anuitete gjysmëvjetore duke filluar prej tetorit të vitit 2011. Në grejs periudhën nga viti 7, që paraqet edhe periudhë realizimi të projektit, kamata do të kapitalizohet.

Neni 4

Në shumën e mjeteve të tërhequra paguhet provizion i njëhershëm për shërbim në lartësi prej 0,1%, në momentin e tërheqjes së mjeteve.

Në anuitetet e arritura, por të papaguara paguhet kamatë ndëshkuese në lartësi prej 3,5% në vit.

Neni 5

Shfrytëzues i fundit i huasë për projektin është Ndërmarrja Publike “Zletovica”.

Neni 6

Huaja do të paguhet nga të ardhurat që do t'i realizojë Ndërmarrja Publike “Zletovica”. Mungesa e mjeteve për servisimin e obligimeve, mbi të ardhurat që do t'i realizojë Ndërmarrja Publike “Zletovica”, do të sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 7

Në qoftë se obligimet e arritura në bazë të kamatës dhe kryegjësë, në afatet e përcaktuara me marrëveshje për hua, në emër të Ndërmarrjes Publike “Zletovica” i paguan Republika e Maqedonisë, Ndërmarrja Publike “Zletovica” është e obliguar që në afat prej 30 ditësh nga dita e kryerjes së obligimit, në dobi të llogarisë të të ardhurave të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë të bartë mjete në denarë në lartësi të pagesës të kryer, të rritura për kamatën e përlllogaritur dhe për shpenzimet e arritura lidhur me transaksionin përkatës.

Ministri i Financave mund t'i urdhërojë Drejtorisë të të Hyrave Publike bllokimin e mjeteve të shfrytëzesit të fundit në bazë të kthimit të TVSH me qëllim të përmbushjes të obligimeve të arritura ndaj kreditorit, gjegjësisht të kompensohen në buxhet mjete në denarë në lartësi të pagesës të kryer, të rritura për kumatën e përllogaritur dhe për shpenzimet e krijuara lidhur me transaksionin përkatës.

Neni 8

Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Hidroekonomisë do të lidhin marrëveshje me Ndërmarrjen Publike “ Zletovica” me të cilën do të rregullohen të drejtat dhe obligimet e reciproke për realizimin e Projektit për përmirësimin e shfrytëzimit të ujit në basenin e lumit Zletovica.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.